



Prishtinë, 31 mars 2017
Kodi i ZRRE-së: V_903_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, Nenit 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për të Hyrat e OSSH-së);
- Dispozitat e rregullës për vendosjen e hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të tregut (Rregulla për të Hyrat e OST/OT-së); dhe
- Propozimin për Strukturën e re Tarifore i datës 17 mars 2017, i nxjerr nga Rregullatori në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE11);

në seancën e mbajtur më 31 mars 2017 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** tarifatat me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale të furnizimit për vitin relevant tarifor SHTE11, që do të zbatohen nga i licencuari KESCO SH.A., duke filluar nga data 1 prill 2017.
- II. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë me shërbime universale të furnizimit, e cila do të zbatohet nga data 1 prill 2017, për vitin relevant tarifor SHTE11 është në tabelën e mëposhtme:



Grupi Tarifor	Niveli I tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Tarifat
1	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.80
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.00
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.00
2	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.80
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh		5.52
3	0.4kV (familjarë pa matës)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.80
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë mesatare	7.00

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1tetor deri më 31 mars
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1prill deri më 30 shtator

Tabela1:Tarifa me pakicë e Energjisë Elektrike për konsumatorët e rregulluar familjarë

III. Struktura e tarifave me pakicë e energjisë elektrike për konsumatorët jofamiljarë me shërbime universale të furnizimit, e cila do të zbatohet nga data 1 prill 2017, për vitin relevant tarifor SHTE11 është në tabelën e mëposhtme

Grupi Tarifor	Niveli I tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Tarifat
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		12.21
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		6.40
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	5.37
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.45
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.73
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		5.05
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.51
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.25
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.02
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.73
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.86
		Fuqia e angazhuar	€/kW		3.23
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.30
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.41
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.73
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.24
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	9.63
			€/kWh	Tarifë e Lartë	11.68
				€/kWh	Tarifë e Ulët
5	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.50
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e vetme	10.09

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1tetor deri më 31 mars
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1prill deri më 30 shtator
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me $\cos(\Phi) < 0.95$

Tabela2:Tarifa me pakicë e Energjisë Elektrike për konsumatorët e rregulluar jofamiljarë



ARSYETIM

- ✚ Rregullatori me datë 17 mars 2017 ka nxjerr në konsultim publik propozimin për strukturën e re tarifore;
- ✚ Rregullatori për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me shërbime universale të furnizimit ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në faqen zyrtare të saj si në vijim:
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OST/OT-së, i publikuar më datën 28 Shkurt 2017;
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OSH-së, i publikuar më datën 28 Shkurt 2017;
 - Propozimin për strukturën e re tarifore, i publikuar më datën 17 mars 2017;
 - Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OST/OT, i publikuar më datën 31 mars 2017; dhe
 - Raport përfundimtar për të hyrat e lejuara maksimale të OSSH-së, i publikuar më datën 31 mars 2017;
- IV. Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V. Në rast të devijimeve në të hyrat që mund të rezultojnë nga aplikimi i tarifave të përcaktuara me dispozitivin nën pikën II të këtij vendimi dhe kostove të arsyeshme që mund ti shkaktoj i Licencuari, Rregullatori do të bëjë përshtatjet e nevojshme në vitin e ardhshëm relevant tarifar.
- VI. KESCO mund të lidh marrëveshje për furnizimin me konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 110kV, me çmime jo më të larta se çmimet mesatare të realizuara në periudhën 1 prill 2016 deri me 31 mars 2017.
- VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të zbatohet nga Furnizuesi me obligim të furnizimit në kuadër të shërbimit universal duke filluar nga data 1 prill 2017 dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, tridhjetë (30) ditë, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Krenar Bujupi, u.d kryesues

Arsim Janova, anëtar,

Besim Sejfiqaj, anëtar,

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.